



Komuna e Hanit të Elezit

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING  
REPUBLICA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT  
KOMUNA HANI I ELEZIT, OPSTINA HANI I ELEZIT, MUNICIPALITY HANI I ELEZIT  
Nr. 01 / 298 of 05/05/2020 Date: 05/05/2020  
HANI I ELEZIT



Islamic Relief Kosova

No: A. 01/2020

## Marrëveshje bashkëpunimi / Agreement

Ndërmjet / Between

Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office

dhe / and

Komuna e Hanit të Elezit (Komuna) / Municipality of Hani i Elezit

Për realizimin e projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes **Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW)** dhe **Komuna e Hani i Elezit (Komuna)** në lidhje me bashkimin e mjeteve/fondeve për projektin "Kujdesi shtëpiak për lehonat, personat e moshës së tretë dhe me aftësi të kufizuara" faza dytë që është pjesë e projektit të IRW me pin kod numër **020\_003419** përkrahur nga zyra e Islamic Relief në Gjermani.

### Neni 1 Qëllimi i marrëveshjes

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përcaktojë formën e bashkëpunimit mes IRW dhe Komunës me qëllim të implementimit dhe finalizimit të projektit që ka për qëllim ofrimin e shërbimeve shëndetësore me rastin e vizitave mjekësore nga ana e stafit shëndetësorë, pa pagesë për të gjithë banorët e Komunës, me fokus në vizita në shtëpitë e tyre, të lehonave dhe foshnjave, personave me aftësi ndryshe, personave me sëmundje kronike si dhe personave të moshës së shtyrë me pin kod **020\_003419** që implementohet nga ana e IRW.

For the realization of the humanitarian project through the service of conditions between Islamic Relief Worldwide - office in Kosovo (IRW) and the Municipality of Hani i Elezit regarding the join of funds / donations for the project "**Home care for nursing mothers, elderly and disabled people**" second phase for the Municipality of Hani i Elezit which is part of the IRW project with pin code number **020\_003419** supported by Islamic Relief office in Germany.

### Article 1 Purpose of the agreement

1.1 The purpose of this agreement is to determine the form of cooperation between IRW and the Municipality in order to implement and finalize the project that aims to provide health services in case of medical visits by health staff, free of charge for all residents of the Municipality , with a focus on visits to their homes, nursing mothers and infants, people with disabilities, people with chronic illnesses and people of advanced age with the pin code **020\_003419** implemented by IRW.

A.G

RS

<p>1.2 Përfitues nga ky projekt do të jenë të gjithë banoret e Komunës së Hani i Elezit. Prej tyre përfitues direkt përafërsisht llogaritet të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 750 gra lehana me foshnjet e tyre,</li> <li>- 5000 persona të moshës së tretë gra dhe burra,</li> <li>- 1000 persona me aftësi të kufizuara</li> </ul>	<p>1.2 Beneficiaries of this project will be all residents of the Municipality of Hani i Elezit. Of these, the direct beneficiaries are approximately:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 750 nursing mothers with their babies,</li> <li>- 5000 elderly women and men,</li> <li>- 1000 people with disabilities</li> </ul>
<p><b>Neni 2</b> <b>Përshkrimi i projektit</b></p>	<p><b>Article 2</b> <b>Project description</b></p>
<p>2.1 Menaxhues i projektit është IRW në bashkëpunim me QKMF – Hani i Elezit, dhe participimi i Komunës do të bëhet me anë të transferit të mjeteve të komunës në llogarinë bankare të IRW, pas dëshmive të faturuara të shpenzimeve dhe raportit të shërbimeve të ofruara për çdo muaj.</p>	<p>2.1 The project is managed by IRW in cooperation with the QKMF- Hani i Elezit and the municipality's participation will be made by transferring the municipality's funds to the bank account of IRW NLB 1708200008014285, after signing the agreement. The IRW will send expense reports along with scanned invoices every month.</p>
<p>2.2 Procedurat e selektimit të mjekëve dhe infermierëve të cilët do të angazhohen për punë në terren do të organizohet nga IRW me komision për selektimin e kandidatëve, në këtë rast këtë vit do të vazhdonjë punën infermieret dhe doktorët e angazhuar gjatë vitit 2019 dhe organizimi i konkursit dhe komisionit do të bëhet për të plotësua numrin e kandidateve të paraparë në projekt në rast të nevojës për vitin 2020/2021</p>	<p>2.2 The selection procedures for doctors and nurses who will be engaged in field work will be organized by IRW with a commission for the selection of candidates, in this case this year will continue the work nurses and doctors engaged during 2019 and the organization of the competition and the commission will be made to meet the number of candidates foreseen in the project in case of need for 2020/2021</p>
<p>2.3 Monitorimin, organizimin si dhe raportimin për kuantitetin si dhe kualitetin e shërbimeve ta bëjë koordinatori/ mbikëqyrësi i projektit i cili do të jetë në bashkëpunim të rregullt me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunë.</p>	<p>2.3 Monitoring, organization and reporting on the quality and quality of services should be done by the project coordinator / supervisor who will be in regular cooperation with the Main Center of Family Medicine in the Municipality.</p>
<p><b>Neni 3</b> <b>Obligimet e palëve</b></p>	<p><b>Article 3</b> <b>Obligations of the parties</b></p>
<p><b>3.1 Participimi finansiar</b></p> <p>3.1.1 Në kuadër të projektit me pin kod <b>020_003419</b>, IRW do të sigurojë pjesën e fondevë në vlerë prej <b>65,000.00</b> (gjashtëdhjetë e pesë mijë) ose <b>74.71%</b> të vlerës totale për implementim të këtij projekti ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.</p>	<p><b>3.1 Financial participation</b></p> <p>3.1.1 Under the pin code project <b>020_003419</b>, IRW will provide part of the funds in the amount of <b>€65,000.00</b> (Sixty five thousand euros) or <b>74.71 %</b> of the total value for implementation of this project as set out in Annex A of this Agreement.</p>

A . G

RS

<p>3.2 Në kuadër të buxhetit Komunal, Komuna do të participojë me kontribut finansiar në shumën prej <b>€ 22,000.00</b> (njëzet e dy mijë euro) ose <b>25.29 %</b> të vlerës totale për implementimin e këtij projekti ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje, transferi do të bëhet në xhirollogarinë e Islamic Reief NLB - <b>1708200008014285</b>.</p> <p>3.2.2 Total vlera e projektit është <b>€ 87, 000.00 (tetë dhjetë e shtatë mijë euro)</b> derisa shpenzimet për shërbime do të bëhen sipas zërave që janë paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.</p> <p>3.2.3 Komuna e Hani i Elezit, përmes QKMF – së menaxhon me kuadrin profesional të angazhuar si pjesë e projektit dhe vendos për mënyrën apo vendin e dhënes së shërbimeve në pajtim me shtojcën B'.</p>	<p>3.2 Within the Municipal budget, the Municipality will participate with a financial contribution in the amount of <b>€ 22,000.00</b> (twenty two thousand euros) or <b>25.29%</b> of the total value for the implementation of this project as presented in Annex A of this Agreement, the transfer will be made to the account of Islamic Reief NLB - <b>1708200008014285</b>.</p> <p>3.2.2 The total value of the project is <b>€ 87,000.00</b> (Eight hundred and seven thousand Euros) while the costs for services will be incurred in accordance with the items set out in Annex A to this Agreement.</p> <p>3.2.3 The Municipality of Hani i Elezit, through QKMF, manages the professional staff engaged as part of the project and decides on the manner or place of providing services in accordance with Annex B'.</p>
<p><b>Neni 4</b> <b>Përgjegjësitë e palëve</b></p> <p>4.1 Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përbushur përgjegjësitë sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse në çdo kohë komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas Marrëveshjes, menjëherë do të njoftojë IRW - Koordinatoren e Programit si dhe e kundërtat.</p> <p>4.2 Të dyja palët bien dakord për të emëruar koordinatorët për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje.</p> <p>4.3 Koordinatorët do të janë përgjegjës për rolet e institucionit të tyre dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.</p> <p>4.4 Personi kontaktues i caktuar nga Komuna pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje si dhe personi kontaktues i caktuar nga IRW pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje.</p>	<p><b>Article 4</b> <b>Responsibilities of the parties</b></p> <p>4.1 It is understood by both parties to this Agreement that each party must be capable of fulfilling its responsibilities under this Agreement. If at any time the municipality is unable to perform its functions under the Agreement, it shall immediately notify IRW - Program Coordinator and vice versa.</p> <p>4.2 Both Parties agree to appoint coordinators for the successful implementation of this Agreement.</p> <p>4.3 The Coordinators shall be responsible for the roles of their Institution and for ensuring the successful implementation of the articles of this Agreement.</p> <p>4.4 The Contact Person designated by the Municipality agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement and the Contact Person designated by IRW agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement.</p>

A.7

3

PS

<p><b>Neni 5</b></p> <p><b>Numri dhe asetet e angazhuara në Projekt</b></p> <p>5.1 Numri i profesionistëve shëndetësor dhe teknik që do të angazhohen në projekt me qëllim të realizimit të suksesshëm të dhënies së shërbimeve shëndetësore është së paku 11 (njëmbëdhjetë persona), prej tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 (shtatë) infermierë të përgjithshëm me orar të plotë pune,</li> <li>- 3 (tre) doktorë të përgjithshëm me orar të plotë pune dhe</li> <li>- 1 vozitës me orar të plotë pune</li> </ul> <p>5.2 Në rast të mos plotësimit të numrit me mjek të përgjithshëm, zëvendësimi bëhet me staf infermierik.</p>	<p><b>Article 5</b></p> <p><b>Number and assets engaged in the Project</b></p> <p>5.1 The number of health and technical professionals who will be engaged in the project in order to successfully carry out the provision of health services is at least 1 (eleven people), of which:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 (seven) full-time general nurses,</li> <li>- 3 (three) general doctors with full working hours and</li> <li>- 1 full-time driver</li> </ul> <p>5.2 In case of non-completion of the number with a general practitioner, the replacement is done with nursing staff.</p>
<p><b>Neni 6</b></p> <p><b>Koordinatorët</b></p> <p><b>6.1 Koordinatori për IRW</b> Emri: Albulena Gashi Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, NO. 10 / A Prishtinë, Republika e Kosovës Zyra Telefon: 038 232 431 / mob.044/239-349 Email: <a href="mailto:albulena.gashi@ir-rks.org">albulena.gashi@ir-rks.org</a></p> <p><b>6.2 Koordinatori për Komunë</b> Emri: Besiana Bushi-Thaqi Adresa: Hani i Elezit Telefoni: QKMF – Hani Elezit Tel/Fax: 044/ 139 714 Email: <a href="mailto:besa_bushi@live.com">besa_bushi@live.com</a></p>	<p><b>Article 6</b></p> <p><b>Coordinators</b></p> <p><b>6.1 IRW Coordinator</b> Name: Albulena Gashi Address: Bajram Kelmendi Street, NO. 10 / A Pristina, Republic of Kosovo Office Phone: 038 232 431 / mob.044 / 239-349 Email: <a href="mailto:albulena.gashi@ir-rks.org">albulena.gashi@ir-rks.org</a></p> <p><b>6.2 Coordinator for the Municipality</b> Name: Besiana Bushi-Thaqi Address: Hani i Elezit Phone: QKMF – Hani Elezit Tel / Fax: 044/ 139 714 E-mail: <a href="mailto:besa_bushi@live.com">besa_bushi@live.com</a></p>
<p><b>Neni 7</b></p> <p><b>Gjuha zyrtare e marrëveshjes</b></p> <p>7.1 Gjuha që mbizotëron në këtë marrëveshje është versioni në Gjuhën shqipe dhe Angleze.</p>	<p><b>Article 7</b></p> <p><b>Official language of the agreement</b></p> <p>7.1 The language prevailing in this Agreement is the both Albanian and English languages version.</p>

A. S

PB

**Neni 8**  
**Kohëzgjatja e marrëveshjes**

8.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të Drejtorit për Kosovë të Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë, dhe kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit, dhe do të vazhdojë deri më 28/02/2021 kur pritet edhe të përfundojë realizimi dhe faza e monitorimit të projektit.

**Neni 9**  
**Mosmarrëveshjet**

9.1 Në rast të ngecjeve të realizimit të projektit palët pajtohen që të bëjnë ndryshimin e kësaj marrëveshjeje për një periudhë tjeter me aneks të ri të kësaj marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga të dyja palët.


**Article 8**  
**Duration of the agreement**

8.1 This Agreement shall enter into force upon signature of the Director for Kosovo of the Islamic Relief Worldwide office in Kosovo, and the Mayor of Hani i Elezit, and shall continue until 28/02/2021 when the implementation and monitoring of the project is expected to be completed.

**Article 9**  
**Disputes**

9.1 In the event of project implementation delays, the Parties agree to amend this Agreement for another period with a new Annex to this Agreement in writing and signed by both parties.

Islamic Relief Worldwide – Kosova Office


  
Dr. Mohamed Soliman

Country Director Islamic Relief Kosova

Data/Date: 7/05/2020



Komuna e Hanit të Elezit / Municipality of Hani i Elezit

  
Z. Rufki Suma  
Kryetar / Mayor

Data/Date: 07/05/2020



## SHTOJCA A/ APPENDIX A

Përkujdesi shtëpiak për lehonë dhe foshnjë, persona të moshës së shtyrë, persona me sëmundje kronike dhe persona me aftësi ndryshe – 2020/2021./ Home care for nursing mothers and babies, elderly, people with chronic diseases and people with different abilities - 2020/2021.

Activity /aktiviteti	Units Njësi	Unit price çmimi njësi	Months Muaj	Total	Germany %	Municipality HiE %	Germany EUR	Municipality HiE EUR
Labor Charges/Temporary Staff Project coordinator	1	157.50	12	1,890.00	100%	0%	1,890.00	-
Labor Charges/Temporary Staff 3 Doctors full time	3	680.19	12	24,486.84	70%	30%	17,140.79	7,346.05
Labor Charges/Temporary Staff 7 Nurses full time	7	434.32	12	36,483.24	70%	30%	25,538.27	10,944.97
Labor Charges/Temporary Staff 1 Driver full time	1	396.27	12	4,755.24	80%	20%	3,804.19	951.05
Transportation and Logistics Fuel for field needs	1	51.70	6	310.21	100%	0%	310.21	-
Medicines Drugs Medical supplies	1	450.00	12	5,400.00	87%	13%	4,698.00	702.00
Internal Monitoring Field Monitoring costs	1	300.00	1	300.00	100%	0%	300.00	-
Training to Beneficiaries (Brest cancer)	1	400.00	1	400.00	100%	0%	400.00	-
Visibility - Uniforms for project staff	12	32.38	1	388.55	100%	0%	388.55	-
Telecommunication Expenses Mobile Top - Up	1	20.00	12	240.00	50%	50%	120.00	120.00
Publicity Video & photos for project needs	1	510.00	1	510.00	100%	0%	510.00	-
Food & Drinks for yearly meeting	1	150.00	1	150.00	100%	0%	150.00	-
Stationaries	1	175.93	1	175.93	0%	100%	-	175.93
IRW Field Office - support costs	1	433.33	12	5,200.00	100%	0%	5,200.00	-
IRW Worldwide - support costs (international)	1	379.17	12	4,550.00	100%	0%	4,550.00	-
IRW Field Office - support costs - Municipality funds	1	146.67	12	1,760.00	0%	100%	-	1,760.00
			Total:	87,000.00	74.71%	25.29%	65,000.00	22,000.00

PS

A. 9

SHTOJCA B

## **1. GRATË SHTATËZËNA DHE LEHONA**

- 1.1 Kujdesi Antenatal** – Përcaktim i shtatzënisé, përcjellja e shëndetit të gruas dhe zhvillimit të frytit. Kujdesi për një stil sa më të mirë të jetës, njoftimi i shtatzënës për shenjet e rrezikshme me qëllim të ofrimit të ndihmës adekuate. Parandalimi i abortit dhe lindjes së parakohshme
  - 1.2 Kujdes postnatal** – ka për qëllim të sigurojë një shëndet dhe mirëqenie sa më të mirë për lehonën dhe të porsalindurin. Kujdesi për lehonën dhe mënjanimi i komplikimeve të pas lindjes përfshirë kontrollin e ndonjë infekzioni të mundshëm, depresionin postnatal si dhe hemorragjitë. Kujdesi në përgjithësi i shëndetit të nënës dhe fëmijës. Metodat dhe mjetet e planifikimit familjar.
  - 1.3 Kujdesi për të sapolindurin** – Adaptimi në jetën ekstraterinë, fillimi i hershëm i gjidhënjës, profillaksa e të porsalindurit, monitorimi i rritjes dhe zhvillimi i të porsalindurit. Njoftimi i të gjitha shtatzënave dhe lehonave për rëndësinë e ushqyeshmërisë së foshnjës me qumësht të gjirit. Rëndësia e ushqyerjes ekskluzive në gjashtë muajt e parë të foshnjërisë. Të njoftohen të gjitha nënët për kohën dhe llojet e ushqimeve plotësuese adekuate. Zbulimi i ndonjë anomalie apo ngecje në zhvillim tek fëmijët.

## **2. KËSHILLIMI I GRAVE RRETH MENOPAUZËS**

Të njoftohen të gjitha gratë me ndryshimet që ndodhin në moshën e pre menopauzës, menopauzës dhe pas menopauzës.

### **3. MOSHA E TRETE MBI MOSHËN 65 VJEÇ**

Zbulimi me kohë i sëmundjeve kronike dhe paaftësive të ndryshme. Adaptimi me moshën e tranizacionit dhe monitorimin e shenjave vitale.

#### **4. PERSONAT ME AFTËSI NDRYSHE**

Për krahja morale, emocionale, ndihma me mjete të nevojshme si karroca për persona me paaftësi në lëvizje, llojet e patericave, këshillim i familjes në lidhje me kujdesin ndaj këtyre personave, ushqimi adekuat, higjenën dhe lëvizshmërinë e tyre për parandalimin e dekubituesit. Ofrimi i të gjitha shërbimeve të nevojshme p.sh. Monitorimi i shenjave vitale, vlerat e glikemisë, aplikimi i terapisë së nevojshme medikamentoze. Për fëmijët me aftësi ndryshe, shfrytëzimi i potencialeve dhe aftësimi i tyre për vet kujdes. Zhvillimi i aftësive profesionale tek kjo kategori e fëmijëve, përfshirja e tyre në shkolla të rregullta, ndërsa me paaftësi më të rënda në shkolla special.

## 5. PERSONAT ME SËMUNDJE KRONIKE

Personat e kësaj kategorie kërkojnë kujdes dhe vëmendje të posaçme. Personat me sëmundje kronike p.sh diabet kanë nevojë për këshillim rreth dietës monitorimit e vlerave të glikemisë, marrjes së terapisë me rregull dhe stilit të shëndetshëm të jetës me qëllim të parandalimit të komplikimeve më të shpeshta siç janë: neropatit diabetike, retinopatite, nefropatite, dhe kujdesi për shputë me qellim të parandalimit të ulcerës diabetike.

Personat me HTA- këshillimi i këtyre personave për stil të shëndetshëm të jetës, zvogëlimi i përdorimit të kripës, aktivitetet e shtyra fizike, shmangja e pirjes së duhanit dhe alkoolit, evitimi stresit. Monitorimi i rregullt i vlerave të TA-së si dhe përdorimi i rregullt i medikamenteve të përshkruara nga mjeku.

## **6. PERSONAT ME SËMUNDJE MALINJE**

Këta persona kanë nevojë në mbështetjen e personelit shëndetësorë në çdo aspekt qoftë në mbështetje emocionale morale dhe ndihmë profesionale. Personeli shëndetësorë duhet të jetë në dispozicion në çdo kohë kur këta persona kanë nevojë.

## **7. DHËNIA E NDIHMËS MJEKËSORE NË AKSIDENTE**

Dhënia e ndihmës së parë të lënduarve në aksident në komunikacion dhe aksidente tjera dhe përcjellja e të lënduarve deri në institucion shëndetësor.

## **APPENDIX B**

### **1. PREGNANCY WOMEN AND NURSING MOTHERS**

**1.1 Antenatal care** - Determination of pregnancy, monitoring of women's health and fetal development. Taking care of a better lifestyle, notifying the pregnant woman of the dangerous signs in order to provide adequate help. Prevention of abortion and premature birth.

**1.2 Postnatal care** - aims to ensure the best possible health and well-being for both the mother and the newborn. Maternity care and avoidance of postpartum complications including control of any possible infection, postnatal depression and hemorrhage. General care of the health of mother and child. Family planning methods and tools.

**1.3 Newborn care** - Extra life adaptation, early breastfeeding, neonatal prophylaxis, growth monitoring and development of the newborn. Notification of all pregnant and lactating women about the importance of breastfeeding. The importance of exclusive nutrition in the first six months of infancy. Notify all mothers of the time and types of adequate complementary foods. Detection of any abnormalities or developmental delays in children.

### **2. ADVISING OF WOMEN ABOUT MENOPAUSE**

Inform all women of the changes that occur in pre-menopausal, menopausal, and postmenopausal age.

### **3. THE ELDERLY OVER 65 YEARS OLD**

Timely detection of chronic diseases and various disabilities. Adaptation to the age of transition and monitoring of vital signs.

### **4. PERSONS WITH DIFFERENT ABILITY**

Moral, emotional support, help with the necessary tools such as wheelchairs for people with disabilities, types of crutches, family counseling about caring for these people, adequate nutrition, hygiene and their mobility to prevent decubitus. Providing all necessary services e.g. Monitoring of vital signs, glycemic values, application of necessary drug therapy. For children with different abilities, using their potentials and training them for self-care. Development of professional skills in this category of children, their inclusion in regular schools, while with more severe disabilities in special schools.

### **5. PERSONS WITH CRONIC DISEASES**

People in this category require special care and attention. People with chronic diseases such as diabetes need to be advised about diet monitoring of glycemic values, regular therapy and a healthy lifestyle in order to prevent more common complications such as: diabetic neuropathy, retinopathy, nephropathy, and foot care in order to prevent diabetic ulcer. People with HTA - counseling these people for a healthy lifestyle, reducing salt use, strenuous physical activity, avoiding smoking and alcohol, avoiding stress. Regular monitoring of TA values as well as regular use of medications prescribed by the doctor.

### **6. PERSONS WITH MALIGNANT DISEASE**

These people need the support of health personnel in every aspect, whether moral emotional support or professional help. Health personnel should be available at any time when these persons are in need.

### **7. MEDICAL HELP IN CASE OF ACCIDENT**

Providing first aid to the injured in traffic accidents and other accidents and escorting the injured to the health institution.

PS